

MINISTRIA E SHËNDETËSISË

FTESA PËR OFERTË

Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Shqipërisë fton investitorë të interesuar vendas dhe/ose të huaj të marrin pjesë në procedurat konkurruese përzgjedhëse për **dhënien me koncesion/partneritet publik privat të shërbimeve të integruara për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterilë, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale.**

Vendndodhja dhe mënyra e tërheqjes së dokumenteve të procedurës konkurruese do të bëhet në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 130, datë 12.3.2014 “Për kryerjen në mënyrë elektronike të Procedurave Konkurruese të dhënies së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat”. Ofertuesit e interesuar mund të njihem me dokumentet standarde të procedurës konkurruese në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik: **www.app.gov.al**.

Kohëzgjatja e kontratës së koncesion/partneritetit publik privat është **10 vjet**.

Per informacione të mëtejshme në lidhje me procedurën ju lutem kontaktoni ne: Të dhënat e kontaktit:

Tel.: 042 376178;

Personi i kontaktit: Marsela Serjani E-mail: marsela.serjani@shendetesia.gov.al

Ofertat do të ngarkohen (upload) në adresën zyrtare të APP-së: www.app.gov.al jo më vonë se data **30.03.2015** ora 12:00.

Çdo ofertë e ngarkuar pas këtij afati nuk do të pranohet.